



Nr. 23202 prot.

Tiranë, më 12.07.2023

LËNDA: POLITIKA E MBROJTJES SË FËMIJËVE.

1. Hyrje

Të gjithë pjesëmarrësit në aktivitetet e FSHR duhet të marrin pjesë në një mjedis të sigurt dhe të këndshëm. FSHR dhe anëtarët kanë detyrimin moral dhe ligjor të sigurojnë që fëmijët dhe të rinjtë nën 18 vjeç, të përfshirë në të gjitha aktivitetet si p.sh. ARDF, HST dhe aktivitete të tjera rinore, të mbrohen nga çdo formë abuzimi, keqtrajtimi apo rreziku.

Qëllimi i politikës është:

- të promovojë praktika të mira;
- të garantojë mbrojtje të duhur për fëmijët;
- të sigurojë reagim të shpejtë dhe të saktë ndaj çdo shqetësimi;
- të udhëzojë vullnetarët dhe organizatorët si të veprojnë në situata të dyshimta.

Një fëmijë, sipas politikës së mbrojtjes së fëmijëve, është çdo person nën moshën 18 vjeç.

2. Parimet kryesore

FSHR angazhohet që:

- mirëqenia e fëmijëve të jetë gjithmonë parësore;
- të gjithë fëmijët, pavarësisht prejardhjes, gjinisë, kulturës apo aftësive, të marrin pjesë në një mjedis sportiv të sigurt;
- të merren të gjitha masat e arsyeshme për t'i mbrojtur nga diskriminimi, abuzimi dhe trajtimi degradues;
- çdo dyshim apo akuzë të merret seriozisht dhe të trajtohet menjëherë;
- vullnetarët që punojnë me fëmijë të jenë të përzgjedhur me kujdes dhe të trajnuar për praktikatat e duhura.

Politika rishikohet çdo 3 vjet ose kur ka ndryshime të rëndësishme ligjore apo organizative.

3. Praktikatat e mira

Të gjithë personat që punojnë me fëmijë duhet të:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ALBANIAN FEDERATION OF RADIO AMATEURS

FEDERATA SHQIPTARE E RADIOAMATORIZMIT

Kutia Postare 201, 1001 Tirana, Albania

M +355 695 8188 50, M +355 676 5050 09

fshra@fshra.org | info@fshra.org | president@fshra.org

- punojnë në mjedise të hapura, jo në ambiente të fshehta;
- promovojnë sport të ndershëm dhe të trajtojnë menjëherë bullizmin;
- trajtojnë fëmijët me respekt dhe dinjitet;
- vendosin mirëqenien e fëmijës mbi çdo objektiv sportiv;
- ruajnë distancë të përshtatshme fizike dhe emocionale;
- shmangin kontaktin fizik të panevojshëm;
- përfshijnë prindërit ose udhëheqësit e ekipeve kur është e mundur;
- marrin pëlqim me shkrim për transport, qëndrime natën, ndihmë të parë, etj.;
- japin feedback konstruktiv, jo kritikë negative;
- mbajnë shënime për çdo incident apo lëndim.

4. Praktikat e gabuara

Duhet të shmangen:

- qëndrimi i gjatë vetëm me një fëmijë;
- transportimi i fëmijëve vetëm, pa prindër;
- vizitat në shtëpi të fëmijëve;
- lojërat fizike të ashpra ose me nëntekst seksual;
- prekje të papërshtatshme;
- gjuhë e pahijshme;
- komente seksuale, edhe "për shaka";
- presion psikologjik, ulërima, poshtërim;
- mosreagimi ndaj akuzave të fëmijëve;
- kryerja e gjërave personale që fëmija mund t'i bëjë vetë.

Nëse ndodh një incident i paqëllimshëm (p.sh. lëndim aksidental), duhet raportuar menjëherë dhe dokumentuar.

5. Llojet e abuzimit

Dokumenti përshkruan katër kategori:

- **Abuzimi fizik** – dhunë, trajtim i ashpër, stërvitje sportive e tepruar.
- **Abuzimi emocional** – poshtërim, frikësim, presion, bullizëm.
- **Neglizhenca** – moskujdesi për nevojat bazë, ekspozimi ndaj rrezikut.
- **Abuzimi seksual** – çdo formë sjelljeje seksuale, kontakt, ekspozim ndaj pornografisë.

Bullizmi trajtohet si formë e abuzimit emocional ose fizik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ALBANIAN FEDERATION OF RADIO AMATEURS

FEDERATA SHQIPTARE E RADIOAMATORIZMIT

Kutia Postare 201, 1001 Tirana, Albania

M +355 695 8188 50, M +355 676 5050 09

fshra@fshra.org | info@fshra.org | president@fshra.org

6. Shenjat e mundshme të abuzimit

Indikatorët mund të jenë:

- plagë të pashpjeguara;
- sjellje e tërhequr, frikë, nervozizëm;
- rënie e papritur e performancës;
- sjellje seksuale e papërshtatshme;
- izolim social;
- ndryshime në ushqyerje, gjumë, higjienë;
- shenja të bullizmit (dhimbje barku, dëmtime, mungesë parash, humbje sendesh).

Prania e një shenje nuk është provë, por është arsye për veprim.

7. Reagimi ndaj dyshimeve ose raportimeve

Nëse një fëmijë tregon se është abuzuar:

- dëgjohet me qetësi;
- sigurohet që nuk është fajtor;
- bëhen vetëm pyetje sqaruese;
- informohet se çështja duhet raportuar;
- dokumentohet çdo detaj;
- njoftohet organizatori i aktivitetit;
- në rast urgjence thirret ambulanca.

8. Dokumentimi

Duhet të regjistrohen:

- emri, mosha, adresa e fëmijës;
- natyra e incidentit;
- dëmtime të dukshme;
- dëshmitarët;
- deklarimi i fëmijës;
- kontaktet me prindërit;
- personi i dyshuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ALBANIAN FEDERATION OF RADIO AMATEURS

FEDERATA SHQIPTARE E RADIOAMATORIZMIT

Kutia Postare 201, 1001 Tirana, Albania

M +355 695 8188 50, M +355 676 5050 09

fshra@fshra.org | info@fshra.org | president@fshra.org

9. Raportimi

Çdo dyshim **duhet** të raportohet. Mund të ketë tre hetime:

- **penale** (policia);
- **mbrojtje e fëmijëve** (autoritetet sociale);
- **disiplinore** (FSHR dhe klubet sportive anëtare).

Kur personi i dyshuar është udhëheqës i ndonjë grupi, raportimi bëhet tek Presidenti i FSHR.

10. Konfidencialiteti

Informacioni ndahet vetëm me:

- kryetarin e grupit rinor;
- prindërit;
- personin që ka raportuar;
- personin e dyshuar;
- policinë në rastet e rënda.

Dokumentet ruhen në mënyrë të sigurt.

11. Pezullimi dhe hetimi i brendshëm

Organizatori ose kryetari i grupit sportiv mund të pezullojë menjëherë personin e dyshuar. Komiteti Ekzekutiv vendos për rikthimin ose ndalimin e tij, duke pasur parasysh vendosur në plan të parë mirëqenien e fëmijës.

12. Detyrimet e vullnetarëve, shoqëruesve dhe pjesëmarrësve

Të gjithë personat që punojnë me fëmijë duhet:

- të lexojnë dhe nënshkruajnë politikën;
- të kuptojnë sjelljet e lejuara dhe të ndaluara;
- të raportojnë çdo sjellje të papërshtatshme;
- të sigurojnë prani të një personi të trajnuar për ndihmën e parë.



PRESIDENTI I FSHR

Florian Gijonej

Për organizatorët, anëtarët e jurisë dhe vullnetarët e angazhuar në aktivitet

DEKLARATË

Unë, i/e nënshkruari/a, kam lexuar dhe kuptuar kërkesat e FSHR në lidhje me **Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve**. Deklaroj se do të zbatoj plotësisht kërkesat e kësaj politike dhe do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të siguruar respektimin e saj gjatë aktivitetit sportiv.

Konfirmoj se **nuk jam subjekt i asnjë procedimi penal** dhe nuk kam asnjë dënim penal, përveç kundërvajtjeve të mundshme të trafikut rrugor që janë të natyrës administrative.

Emri e Mbiemri: _____ me Nr. ID _____

Pozicioni në [organizim / federatë / klub]: _____

Vendi dhe Data: _____, ____/____/____

Nënshkrimi: _____

DEKLARATË

Në emër të ekipit _____, unë, i/e nënshkruari/a, kam lexuar dhe kuptuar kërkesat e FSHR në lidhje me Parimet e Mbrojtjes së Fëmijëve.

Deklaroj se do të zbatoj plotësisht këto parime dhe do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të siguruar respektimin e tyre.

Konfirmoj se **nuk jam subjekt i asnjë procedimi penal** dhe nuk kam asnjë dënim penal, përveç kundërvajtjeve të mundshme të trafikut rrugor që janë të natyrës administrative.

Emri e Mbiemri: _____ me Nr. ID _____

Pozicioni në [klub / ekip]: _____

Vendi dhe Data: _____, ____/____/____

Nënshkrimi: _____

DEKLARATË

Ne, _____ me Nr. ID _____ dhe _____
me Nr. ID _____, jemi prindërit/kujdestarët e _____, i lindur
më ____/____/____ me Nr. ID _____.

Ne jemi dakord që fëmija ynë të marrë pjesë në aktivitetin sporti të organizuar nga Federata
Shqiptare e Radioamatorizmit, të shoqërohet nga udhëheqësi/udhëheqësja e grupit sportiv
z./znj. _____, me Nr. ID _____, në itinerarin drejt, gjatë
aktivitetit sportiv dhe deri në kthim.

Kërkojmë që fëmijës dhe personit shoqërues t'u ofrohet çdo ndihmë e nevojshme gjatë udhëtimit,
gjatë aktivitetit dhe në kthim.

Detajet e udhëtimit: _____

Numri i telefonit të prindërve: _____

Adresa e prindërve: _____

Vendi dhe Data: _____, ____/____/____

Nënshkrimet: _____